

KOSOVARJA

ALBERT BUCOLLI:

Suksesi nuk ndërtohet mbi
fatin, por mbi punën,
durimin dhe këmbënguljen





ELIZA PARK A
SUHAREKË

NJË PAMJE QË E BËN CDO
MËNGJES TË VECANTË.



Albert Bucolli:

*Suksesi nuk ndërtohet
mbi fatin, por mbi punën,
durimin dhe këmbënguljen*

Nga Drenica në Gjermani, rrugëtimi i Albert Bucollit është një histori e ndërtuar mbi sakrificën, punën dhe këmbënguljen. Arriti në Gjermani me vetëm 20 euro në xhep dhe nisi gjithçka nga e para.

Sot, pas viteve të përkushtimit, drejton një grup kompanish që operojnë në ndërtim, renovim, menaxhim dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme, ndërsa ka zgjeruar aktivitetin edhe në sektorin e hotelerisë.

Por, pas suksesit në biznes qëndron një histori shumë më e thellë: përvojat e luftës, sakrificat e nënës, emigrimi, ndërtimi i një jete të re dhe lidhja e pandarë me Kosovën.

Për Bucollin sukcesi nuk matet vetëm me pasurinë e krijuar, por me besimin, familjen dhe vlerat që lë pas. Në këtë intervistë për Revistën tonë rrëfen rrugëtimin e tij, filozofinë e biznesit, planet për investime dhe mesazhin për gjeneratën e re shqiptare.

Në ballinë: Albert Bucolli

Njiheni si biznesmen i suksesshëm në Gjermani. Si do ta përshkruani rrugëtimin tuaj nga Kosova deri te ky sukses?

- Rrugëtimi im është historia e një njeriu që nuk e pat rrugën të shtruar.

U nisa nga Drenica me një çantë, 20 euro në xhep dhe shumë dhimbje për vendlindjen.

Në Gjermani fillova nga zero. Punova, u përballa me shumë sfida dhe çdo ditë u përpoqa të ndërtoja një jetë më të mirë. Sot suksesi im është rezultat i punës së ndershme, këmbënguljes dhe besimit të klientëve e partnerëve. Mbi të gjitha, jam mirënjohës që nuk kam harruar kurrë prej nga vij...

Keni qenë pjesëtar i UÇK-së. Sa kanë ndikuar përvojat e asaj periudhe në karakterin dhe mënyrën se si e udhëhiqni biznesin sot?

- Lufta ishte ndër periudhat më të vështira, por edhe më formuese të jetës sime. Më mësoi vlerën e lirisë, besnikërisë, përgjegjësisë dhe, mbi të gjitha, të mos dorëzohem.

Një falënderim të veçantë ia kushtoj nënës sime, e cila rrezikoi jetën shumë herë për të më mbajtur gjallë.

Po ashtu, kujtoj me përjetësi shokët që ranë për lirinë e Kosovës. Borxhi ndaj tyre nuk shlyhet kurrë. Mënyra më e mirë për t'i nderuar është ta ruajmë lirinë dhe të ndërtojmë një Kosovë më të mirë.

Emigrimi nuk është i lehtë për askënd. Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha gjatë viteve të para në Gjermani?

- Fillimi ishte shumë i vështirë. Duhej të përballesh me gjuhën, kulturën, ligjet dhe një mënyrë krejt tjetër të jetës. Një nga sfidat më të mëdha ishte fitimi i besimit. Në Gjermani besimi nuk fitohet me fjalë, por me punë, rezultate dhe korrektësi.

Sot mendoj se pikërisht ato vite më formuan si njeri dhe si sipërmarrës.

A ka pasur ndonjë moment kur keni menduar të hiqnit dorë nga ëndrra për të ndërtuar një karrierë në biznes?

- Pa mëdyshje, kam pasur momente të vështira, por nuk kam menduar ta braktis ëndrrën. Kam menduar gjithmonë se si ta ndryshoj strategjinë, të mësoj nga gabimet dhe të vazhdoj përpara.

Besoj se suksesi nuk matet vetëm me fitoret, por me mënyrën se si reagojmë kur gjërat shkojnë keq.

Çfarë ju shtyri të orientoheshit drejt sektorit të patundshmërive dhe menaxhimit të pronave?

- Patundshmëritë i kam parë si mundësi për të krijuar vlerë dhe për të ndërtuar

diçka që mbetet. Ky sektor kërkon vizion, disiplinë dhe guxim.

Besoj se investimet e suksesshme nuk ndërtohen mbi fatin, por mbi njohurinë, punën dhe aftësinë për të parë mundësitë.

Sot kompania juaj, KÖNIGS VILLEN IMMOBILIEN GmbH, është e njohur për menaxhimin profesional të pasurive dhe kujdesin për ndërtesat. Cila është filozofia që e dallon kompaninë tuaj në treg?

- Parimi ynë është i thjeshtë: besimi fitohet me rezultate, jo me premtime. Ne nuk menaxhojmë vetëm prona; mbrojmë investimet e klientëve dhe synojmë të rrisim vlerën e tyre.

Profesionalizmi, transparenca dhe përgjegjësia janë baza e punës sonë. Ndërtesat ndërtohen me beton, por një kompani ndërtohet me integritet dhe besim.

Si ka evoluar kompania nga dita e themelimit deri në pozicionin që ka sot?

- Rrugëtimi nisi me SGN BAU Bucolli, mbi bazën e punës, disiplinës dhe standardeve të larta. Më pas u krijuan Bucolli Maler-Stuckateur GmbH dhe KÖNIGS VILLEN IMMOBILIEN GmbH.

Sot kemi një grup kompanish që mbulon ndërtimin, renovimin, menaxhimin dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme. Për mua suksesi nuk matet me numrin e kompanive, por me vlerën, reputacionin dhe besimin që ndërtojnë.



Përtej shifrave dhe suksesit financiar, çfarë konsideroni arritjen tuaj më të madhe në biznes?

- Arritja më e madhe është besimi i klientëve, partnerëve dhe bashkëpunëtorëve.

Jam krenar edhe për vendet e punës që kemi krijuar dhe për njerëzit që janë zhvilluar profesionalisht në kompanitë tona. Nuk dua të kujtohem vetëm për investimet, por për standardet dhe vlerat që kam mbrojtur.

Çfarë kërkon tregu gjerman i patundshmërive dhe si arrini t'u përgjigjeni pritshmërive të klientëve?

- Tregu gjerman kërkon profesionalizëm, siguri, transparenca dhe reagim të shpejtë. Ne kemi investuar në procese të qarta dhe dixhitalizim, por besoj se teknologjia nuk e zëvendëson marrëdhënien njerëzore. Komunikimi dhe respekti ndaj klientit mbetën thelbësore. Duhet të jesh gjithmonë i gatshëm të përshtatesh, sepse tregu ndryshon vazhdimisht.

Sa e vështirë është të fitosh besimin në një treg konkurrues si ai gjerman?

- Besimi fitohet me kohë, punë dhe rezultate. Në Gjermani nuk mjaftojnë fjalët; duhet ta dëshmosh veten. Si emigrant kjo përgjegjësi është ndoshta edhe më e madhe, por më ka motivuar të jem më i përgatitur dhe më i disiplinuar. Edhe kur kam refuzuar mundësinë për të mos bërë kompromis me standardet tona, në planin afatgjatë kjo ka qenë një fitore.

Përveç sektorit të patundshmërive, keni investuar edhe në hotele. Çfarë ju tërheqë në industrinë e mikpritjes?

- Hoteleria më tërheq sepse ndërthurë investimin me përvojën njerëzore. Nuk krijojmë vetëm një biznes, por edhe përvoja dhe kujtime. E shoh si një sektor me potencial afatgjatë që kërkon vizion, disiplinë dhe standarde të larta. Për mua, një hotel është pasqyrim i filozofisë së investitorit...

Kur merrni një vendim për një investim të ri, çfarë analizoni fillimisht?

- Çdo investim nis me pyetjen: "A do të ketë vlerë edhe pas 10 apo 20 vjetësh?". E, nëse përgjigjja nuk është bindëse, nuk investoj. Nuk ndjek fitimet e shpejta, por projektet që krijojnë vlerë të qëndrueshme.

Sa rol luan familja në jetën dhe vendim-marrjen tuaj?

- Familja është forca ime më e madhe. Biznesi mund të të jep sukses, por familja të jep paqe, forcë dhe motivim. Në fund të ditës kompanitë dhe investi-



met mbesin jashtë derës së shtëpisë. Familja është vendi ku gjej energjinë për të vazhduar tutje...

Si arrini ta balanconi jetën profesionale me atë personale?

- Balanca kërkon disiplinë dhe planifikim. Me kalimin e viteve kam kuptuar se nuk mund të japësh më të mirën në biznes nëse nuk ruan ekuilibrin në jetën personale. I kushtoj rëndësi punës, por edhe familjes, pushimit dhe energjisë personale. Suksesi afatgjatë kërkon edhe marrëdhënie të shëndosha dhe qetësi...

Edhe pse jetoni prej vitesh në Gjermani, sa e lidhur mbetet zemra juaj me Kosovën?

- Kosova është vendi ku hodha hapat e parë dhe mora mësimet që më formuan. Edhe pse jetoj dhe punoj në Gjermani, zemra ime ka mbetur gjithmonë e lidhur me vendin nga vij. Sa herë kthehem në Kosovë ndiej një emocion të veçantë. Është kthim te rrënjët. Për mua suksesi nuk është vetëm të ndërtohet diçka për veten, por edhe të kesh mundësi t'i japësh diçka vendit tënd.

A investoni apo planifikoni të investoni edhe në Kosovë? Në cilat fusha shihni potencialin më të madh?

- Kosova ka potencial të madh dhe një brez të ri me energji e ide. Kam menduar dhe vazhdoj të mendoj për investime në Kosovë. Më shumë potencial shoh në pa-tundshmëri, hoteleri, turizëm dhe energji

të pastër. Këto fusha mund të krijojnë vende pune dhe të sjellin standarde të reja.

Besoj se investimi në Kosovë nuk është vetëm çështje biznesi, por edhe përgjegjësi ndaj vendit nga vijnë. Megjithatë, çdo investim duhet të mbështetet në analizë dhe vizion afatgjatë.

Çfarë mendoni se i mungon më së shumti biznesit shqiptar për të qenë edhe më konkurrues në tregjet evropiane?

- Nuk na mungon talenti. Kemi njerëz të zgjuar, punëtorë dhe kreativë. Ajo që duhet të forcojmë është kultura afatgjatë e biznesit. Duhet më shumë profesionalizëm, teknologji, edukim dhe bashkëpunim. Në Evropë nuk mjafton një produkt i mirë; duhen standarde, transparencë dhe vazhdimësi. Nuk duhet të konkurrojmë me çmimin më të ulët, por me vlerën më të lartë.

Çfarë cilësish duhet të ketë një sipërmarrës për të pasur sukses në një vend si Gjermania?

- Integritet, disiplinë dhe përgjegjësi. Duhet të jesh i gatshëm të mësosh vazhdimisht, të përshtatesh dhe të kesh durim. Suksesi ndërtohet me punë dhe besim. Në fund, kur respekton klientët, partnerët dhe ekipin, ndërton jo vetëm një kompani, por një emër që zgjat.

Nëse do u duhej ta përshkruanit Albert Bucollin me tri fjalë, cilat do të ishin ato?

- Këmbëngulës, i pathyeshëm dhe besnik ndaj parimeve të mia. Këto janë vlera që nuk i kam mësuar në libra, por në jetë.

Çfarë u motivon të zgjoheni çdo mëngjes me të njëjtin entuziazëm për punën?

- Dëshira për të qenë një Albert më i mirë se ai i djeshmi. Çdo ditë përpiqem të mësoj diçka të re, t'i korrigjoj gabimet dhe të bëhem më i mirë si udhëheqës, bashkëshort, baba dhe njeri. Gara ime më e rëndësishme është me veten. Nëse sot jam më i mirë se dje e konsideroj ditën një fitore.

Si e përkufizoni suksesin sot? A ka ndryshuar ky përkufizim me kalimin e viteve?

- Kur isha më i ri suksesin e lidhja kryesisht me kompaninë dhe stabilitetin financiar. Sot e shoh shumë më gjerë. Suksesi matet me besimin që ke fituar, njerëzit që ke ndihmuar dhe gjurmën që lë pas. Për mua është ekuilibri mes arritjeve profesionale, familjes, integritetit dhe kontributit për shoqërinë.

Nëse humb vlerat apo familjen, suksesi mbetet jo i plotë.

Cili është mësimi më i vlefshëm që u ka dhënë jeta dhe që nuk do e harroni kurrë?

- Suksesi nuk ndërtohet mbi fatin, por mbi punën, durimin dhe këmbënguljen. Vështirësitë shpesh na formojnë më shumë se sukseset. Kam mësuar të mos harroj nga vij dhe të mos e humbas përlësinë.

Po ashtu, kam kuptuar se koha është pasuria më e madhe. Paratë mund t'i fitosh përsëri, por koha nuk kthehet.

Çfarë këshille do u jepni të rinjve shqiptarë që duan të ndërtojnë një karrierë ose biznes jashtë vendit?

- Të mos kenë frikë të ëndërrojnë, por të kuptojnë se çdo ëndërr kërkon punë dhe sakrificë.

Investoni te vetja, mësoni gjuhë të huaja, zhvilloni aftësitë dhe mos kërkonin rrugë të shkurtra.

Integriteti dhe reputacioni janë ndër pasuritë më të mëdha.

Mos i harroni rrënjët tuaja dhe mos e shihni suksesin si garë me të tjerët.

Gara më e rëndësishme është me veten.

Ku e shihni veten dhe kompaninë tuaj pas pesë apo dhjetë vjetësh?

- Dua që kompanitë tona të jenë edhe më të konsoliduara, me një portofol më të gjerë dhe reputacion më të fortë në tregun gjerman. Por, rritja duhet të vijë pa humbur standardet tona.

Dua të investojmë më shumë në teknologji dhe në zhvillimin e njerëzve. Në planin personal dua të ndaj më shumë përvojën time me brezin e ri dhe të jem pjesë e projekteve që kanë ndikim pozitiv në komunitet.

Në fund, kush është Alberti larg zyrës dhe takimeve të biznesit? Çfarë e bën të lumtur në jetën e përditshme?


- Larg zyrës jam thjesht Alberti – bir, bashkëshort dhe baba. Lumturinë më të madhe e gjej te familja.

Kam kaluar periudha kur nuk e dija nëse do ta shihja të nesërmen. Ndoshta për këtë arsye sot e di se lumturia e vërtetë është të kthehesh në shtëpi dhe të shohësh familjen tënde të buzëqeshur. Kur i shoh të gjithë të ulur në një tryezë, falënderoj Zotin.

Më kujtohen lufta, sakrificat dhe njerëzit që nuk patën mundësinë ta jetonin këtë paqe.

Në fund, jeta nuk matet me atë që ke fituar, por me njerëzit që ke dashur, dashurinë që u ka dhënë dhe kujtimet që ke lënë pas. Kjo është trashëgimia më e madhe që mund të lërë një njeri.

Nderim Neziri



Kush po ma prishë ditën?

Qe dy-tre vjet në televizionet tona rrallë, për të mos thënë fare, mund të hasësh në ndonjë emision ku trajtohet ndonjë problem jetik i popullatës sonë, kurse dominojnë me të madhe debatet politike monotone të analistëve, të cilët ditë e më shumë dalin në skenë si kërpudhat pas shiut...

Është kohë vere dhe normalisht temperaturat janë të larta, edhe pse shumëkush nuk mund t'i përballojë ato, veçmas të moshuarit. Temperaturat e larta, natyrisht, ndikojnë që të mos bëjmë gjumë të mirë, të rehatshëm.

E, kur nuk bën gjumë të mirë, normalisht, nuk ke as disponim.

Dhe, posa zgjohesh në mëngjes, me shpresë se do e largosh sadopak atë monotoni, edhe atë pak disponim që e ke ta prishin emisionet bajate me reprizat e debateve politike ose emisione që nuk përkrijnë me jetën që nisim një ditë të re.

Në një televizion tonin, bie fjala, që në orën 7 në mëngjes këndojnë fëmijët, e dihet se fëmijët nuk zgjohen herët! Në një tjetër televizion, e që është me renome, që në orën 7 të mëngjesit i

thërrasin në emision analistët politikë ose lidhen me ta nëpërmjet telefonit celular se cila parti i takon ta formojë qeverinë, cila parti me cilën do të mund ta zgjidhnin çështjen e presidentit e të tjera të ngjashme.

Dhe, natyrisht, emisionet e tilla jo që të japin forcë për një ditë të mbarë, por edhe atë pak disponim që e ke ta humbin krejt!

E, nëse përcaktohesh për ndonjë televizion të Shqipërisë, atje gjendja është edhe më pus se te ne në Kosovë, sepse, siç thotë populli, atje as s'e di kush ha e as s'e di ku pi! Megjithatë, sado që mundohesh të mos i mbash gjërat afër shpirtit, e keqja është se nuk shihet asnjë xixë në fund të tunelit, e të mos flasim për dritë! Konkretisht, Qeveria jonë shpenzon milion euro për karton të gjelbër të

mërgimtarëve, kurse ditë më parë tavani i dhomave në Klinikën Infektive u ra pacientëve mbi kokë!

Me këtë rast vlen të ceket se mu mjekët e kësaj klinike dy vjet rresht luftuan gjatë pandemisë së koronavirusit, sëmundje e cila mori shumë jetë në Kosovë dhe më gjerë, dhe asnjëherë nuk u dorëzuan...

Sidoqoftë, me këtë rast do theksoja edhe këtë dukuri: Mjekët në Emergjencë të QKUK-së jo vetëm që punojnë në kushte të mjerueshme, por ata ballafaqohen edhe me numër të madh të pacientëve që kërkojnë ndihmë si ditën e si natën, e të mos flasim për rrogat që marrin, rrogë e cila nuk do u mjaftonte as për shpenzimet e gjysmës së muajit.

Dhe, çka jo tjetër?!



PSE NUK PO PËRMIRËSOHEMI?!

Vrasja e kohës është vetëm një emër, për mënyrën tjetër se si koha na vret neve...

Nuk duket racionale përherë ta fajësojmë historinë, ta fajësojmë Evropën, botën për padrejtësitë ndaj kombit dhe popullit tonë. Këto fajëtime nuk janë kontestuese. Po qe se vazhdojmë të merremi me vetveten, do të pranojmë logjikën vetërrënuese. Gjendja në të cilën jemi e vazhdon të jemi, nuk mund të përballohet as lehtë e as shpejt pa bashkimin e forcave. Po qe se këtë nuk e bëjmë, do të ballafaqohemi me plasaritje dhe ndarje të reja. Të tmerrshme. E, plasaritjet, përçarjet dhe ndarjet, populli shqiptar i ka paguar shumë shtrenjtë në të kaluarën... Kërcënohet rreziku që këto të tashmet t'i paguajmë edhe më shtrenjtë. E çuditshme jo pak: nuk po përmirësohemi, nuk po korrigjohemi, nuk po mençurohemi... Thuajse njëjtë, tash e njëqind vjet. Edhe thëniet e shkrimit e para njëqind vjetëve të Fishtës, Nolit e Konicës sikur të jenë të shkruara sot, janë aktuale edhe sot. Sikur janë gjallë në mjedisin tonë, me gjendjen e situatën tonë të përditshme...

*

Me politikë duam të merremi pothuajse të gjithë, edhe pse marrja me politikë kërkon një

prirje të veçantë.

Por, edhe nuk e kanë keq.

Sot politika është biznesi më i mirë, më profitabil.

Shit mend e fjalë – s'ta sheh kush për të madhe, as që ka vend ndërgjegjja, as fytyra.

Vidh sa të duash - as që merresh në përgjegjësi, as që burgosesh. Përkundrazi, fiton privilegje, respekt e poste edhe më të mëdha...

*

Partitë tona gabimet e partive të tjera i qesin para dhe i shohin, ndërsa gabimet e veta i hedhin prapa dhe nuk i shohin!

Partitë, të cilat për vetveten mendojnë se janë të pagabuar, gabojnë më së shumti...

Koha po ecë...

Populli po varfërohet.

Përditë e më i pashpresë.

Përditë në kërkim të gjetjes së rrugës për ikje nga Kosova.

Përditë në pritje – ndoshta nesër bëhet mirë.

Ndërmjet pushtetarëve, partive, përditë mospajtime e përçarjet po vazhdojnë dhe veç çka po ashpërsohen edhe më shumë.

Secili e do bajraktarizmin...

Shtrohet pyetja: Në cilin shekull jemi?

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Anketë me gra e burra të martuar...



Mesazhin e dashnores ma dërgoi gabimisht mua!

Telefoni celular kudo në botë, e veçmas te ne shqiptarët, është mollë sherri i të dashuruarve. Shtrohet pyetja: A mund t'i ruajmë fshehtësitë që i përmban telefoni celular nga njerëzit që i kemi përreth? Andaj, ja se ç' thonë të anketuarit tanë për këtë...

LEMJA, GRUA E MARTUAR: NUK DUA TELEFONIN T'MA KONTROLLOJ AS BURRI!

- Nëse burri dyshon në mua dhe insiston t'ma kontrolloj telefonin, do më mbetet në qafë, sepse do të ndihem keq, se ka dyshime që e tradhtoj, se...

AVNIU, BURRË I MARTUAR: NUK FSHEHË GJË NG GRUAJA IME

- Do më pengonte shumë sikur gruaja do ma kontrollonte telefonin, sepse do mendoja se nuk ka besim në mua, sikur ka mësuar a dëgjuar për ndonjë thashetheme, sepse unë jam ai që i tregoj gjithçka. Nuk jam prej atyre që merren me dashuriçka...
E kam grua atë që më pëlqen, andaj nuk dua të vrapoj pas të tjerave...

LUMJA, E MARTUAR PARA 30 VJETËSH: MESAZHIN E DASHNORES MA DËRGOI GABIMISHT MUA!

- Jam mësuese, nënë e tre fëmijëve të rritur. Im burrë punon në njërin nga ministratë tona. Një ditë, teksa pinim kafe bashkë, ai shkoi në tualet e unë mbeta për pak çaste vetëm. Ndërkohë më erdhi një sms. Ishte nga im burrë. U habita, sepse vetëm pak minuta më parë ishte me mua! Por, edhe më shumë u habita me tekstin që më erdhi. "Nuk vonohem shumë se më ka marrë malli me t'pa!". "Eu, po kush qenka kjo tash!", e solla në mendje. Dhe, nuk bëra zë. U kthye im burrë nga tualeti dhe pasi e rregulloi kravatën, me një përqafim të ftohtë më tha se po shkon në punë, se ka palë në zyrë...

Nuk i thashë gjë, por gjatë ditës nervozova sa vinte e më shtoej...
Kush është ajo?
Si duket ajo?
Sa vjeçe është ajo?
E, sa e sa pyetje të tjera më silleshin në kokë, aq sa në mbrëmje m'u rritë tensioni dhe i thashë troç: "Në mëngjes mesazhin e tjetërkujt ma dërgove mua!".
"Po, obo, ishte një mesazh pa lidhje dhe e shkrova sa për sy e faqe!", ma ktheu. Por, deshi Zoti dhe nuk e zgjatëm shumë dhe ramë të flemë pranë njëri-tjetrit sikur të mos kishte ndodhur asgjë...

PËRFUNDIMI

Ka kohë që telefoni celular është bërë pjesë e pandashme e jetës sonë, por edhe mjet që përçanë, që jep mundësi për grindje. Andaj, për ata që nuk e dinë dhe që kanë dëshirë ta "fusin hundën" gjithkund, përfshirë këtu edhe në gjërat private të tjetërkujt, kjo do të jetë një porosi e qartë...

Diturie Haxhaj

Nga pak...



Lum shkolla që e ka



Studentet kopjojnë edhe në vendet intime!

Qershori dhe fillimi i korrikut është afati kryesor i provimeve për studentët. Secili mundohet të jap sa më

shumë provime. Dhe, për të arritur këtë gjë ndodh edhe kjo si në foton që po e publikojmë: Çfarë nuk bëjnë për

të kopjuar?! Shkruajnë edhe në pjesët më intime të trupit... E, habitshme, a?



Me shkas

A lexojnë kosovarët?

Në ditët e sotme, sipas disa të anketuarve, del se kosovarët lexojnë shumë pak, për të mos thënë fare. Dhe, kjo merret si një nga dukuritë më negative në shoqërinë tonë dhe paraqet rënie të arsimimit dhe edukimit të popullsisë.

Një gjë e tillë shihet qartë edhe në panairin e librit që mbahet çdo vjet te ne, e ku vizitorë ka, por pakkush blen libër!

J. KRASNIQI: MË SË SHUMTI MË PËLQEJNË ROMANET

- Jam nxënës gjimnazi dhe, natyrisht, kemi edhe obligim të lexojmë romane, meqë një gjë e tillë parashihet edhe me programin mësimor në gjuhën shqipe.

Gjatë vitit shkollor thuhajse çdo muaj e kemi obligim ta lexojmë nga një roman, por një gjë e tillë konsiderohet si lexim i obligueshëm. Por, momentalisht, meqë jemi në pushim vjetor, edhe pse nuk e kemi obligim të lexojmë, unë nuk ndahem nga libri, përkundër shëtitjeve që bëj në natyrë, ushtrimeve të rregullta në fitnes dhe daljet

e herëpashershme me shokë për një kafe në ndonjë kafene të lagjes sime. Konkretisht, këto ditë sapo përfundova së lexuari romanin "Hasta la vista" të Petro Markos. Një roman i mrekullueshëm dhe me ngjarje pothuajse të vërtetë.

L. EJUPI, LEXOJ LITERURË QË E KAM OBLIGIM NË FAKULTET

- Në kohën sa isha në Gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë kam lexuar romane edhe jashtë programit shkollor, madje shumë, si romanin "Lumi i vdekur", "Juga e Bardhë" etj. Mirëpo, që nga koha sa jam studente më shumë jam e lidhur me literaturën profesionale të teknologjisë, meqë teknologjia po avancohet nga dita në ditë, kështu që duhet të jem në rrjedhat e kohës.

F. GASHI: SHIKOJ FILMA SE ATY ËSHTË ROMANI!

- Thënë të drejtën, meqë punoj në një butik në Ferizaj, nuk kam kohë të lirë sa i duhet një vaje siç jam unë, e që ka nevojë të takohet me shokë e shoqe në kafene apo gjetiu. Atë pak kohë të lirë që e kam në mbrëmje e shfrytëzoj duke shikuar ndonjë serial turk, sepse në të është romani. Fatkeqësisht, në televizionet tona ka kohë që më nuk kemi seriale shqip dhe kjo më mungon. Andaj, në mungesë të tyre duhet t'i shikojmë serialet e të huajve e që pak kanë realitet me jetën tonë që bëjmë në Kosovë. Keq, a?

URATË ILAZI: PAKKUSH SHPREHET MIRË!

- Njeriu që lexon edhe di të shprehet. E, te ne pakkush lexon, e sidomos të ashtuquajturit VIP-a, të cilët fjalitë i kanë të mangëta, të cingura, herë-herë edhe pa kuptim e logjikë! Sepse, janë dhënë pas profesionit të vet dhe mendojnë se dinë gjithçka!

Ndërkaq, edhe pse lexoj shumë gjëra të ndryshme në telefonin celular, romanin e shkruar në libër, ndonjë novelë a tregim nuk e zëvendëson asgjë.

Andaj, apeloj te moshatarët e mi që t'i kthehen leximit të romaneve, e të mos e humbin kohën kot në rrjete sociale...

PËR FUND

Kohë më parë, pranë Gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë, teksa prisja autobusin numër 4 për në Gërmë, meqë në dorë kisha një libër, i cili atë ditë ishte promovuar në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, e ku isha e pranishme, gruaja rreth të gjashtëdhjetave, e që priste autobusin si unë, më tha: "Bën ta shikoj atë libër?".

"Po", i thashë.

Ajo e shikoi kopertinën dhe nisi ta shfletoj në brendi.

Dhe, në momentin kur shihej duke ardhur autobusi, ma dha librin dhe tha: "Në kohën e rinisë sime çdo libër që na binte në dorë e lexonim, kurse tash rrallëkënd sheh me libër në dorë!".

Diturie Haxhaj

MË SHUMË SE NJË BANESË

Një standard i ri jetese



DAAKONN
INVESTMENT

A do e harrojmë “Mollën e Kuqe”?



“Molla e Kuqe” do të harrohet atëherë kur Serbia ta njeh pavarësinë e Kosovës dhe këtë gjë do e bëjë atëherë kur Kosova të forcohet ushtarakisht. Serbia do na lut atëherë kur ne do të kënaqemi me kufijtë ekzistues dhe nuk do të flasim më për “Mollën e Kuqe”.

Ti e doje Shqipërinë, baba! Shqipërinë etnike.

Nënë Shqipërinë e doje aq sa nuk shihje armiq brenda saj.

Ishin të gjithë shqiptarët aq të mirë për shtetin e vet, ishin aq të dashur dhe xha Enveri ishte njeriu i jetës, të cilin e deshe shumë.

Nuk mund të shkoje ta shihje e të bindeshe nëse ishte Nënë Shqipëria para- jsë apo ferr.

Ishte izolimi ai që të ndaloi të mos shkoje atje dhe atë ditë që ishte nisur për atje kah Kroi i Gorozhupit, dy ditë më parë, armata komuniste e kishte mbyllur çdo rrugë për në Shqipëri.

“QAFË THANA” E BUNKERËVE

Por, ti ke vdekur dhe shumë e shumë gjëra nuk i ke parë.

Nuk di si duket sot Shqipëria, ajo Shqipëri që te “Qafë Thana” ka pamjen e bunkerëve në shkëmbinjtë e dhive të egra.

As ky nuk është lajm për ty baba, e që dergjesh në botën tjetër.

Nuk është lajm as rrënimi i bustit të xha Enverit në kohën e fillimit të përmbysjes së sistemit komunist, apo të skllavërisë totale shqiptare.

U rrëzua busti i Enverit, por nuk ndryshoi populli shumë...

Ky është defekti i Shqipërisë tënde, babë.

Ku është Shqipëria jote që nuk kishte njerëz të dobët kur ishte në pyetje shteti dhe rruga e tij?

Njerëzit kanë provuar të ndryshojnë pas luftës së Kosovës, si këndej ashtu edhe andej kufirit, por jo sa duhet...

Të paktën, të pendohen apo të humbin sa më shumë gjurmë të asaj që kanë shkruar dikur në emër të socializmit.

Një njeri me emër, nga ish - “Rilindja” e Prishtinës, me të përfunduar lufta në Kosovë, u kishte hyrë gazetave që kishte shkruar vetë dhe i heqë me gërvshërë të gjitha shkrimet afirmative të gazetarisë formaliste që lavdëronin shtetin socialist

jugosllav për jubile të Titos, për vëllazërim-bashkim dhe për socializëm.

Dhe, pas tri a katër ditësh punë intensive, i kishte rënë në mend se ekzemplarë të gazetës nuk kishte vetëm ai, por kishin edhe të tjerë...

Dhe, nga sikleti se ekzemplarët i kishin edhe të tjerët, e kishte kapur dhimbja e dhëmbit si kurrë më parë. Kishte shkruar i dërsitur te dentisti dhe kur ai i kishte thënë se duhej t’ia hiqte dhëmbin sepse i ishte prishur, ai i thotë:

“Hiqmi të gjithë!”

“Pse?”, e pyet mjeku.

“Ti nuk e di sa m... e kanë hëngër këta dhëmbë!”

Ja, kjo është pak a shumë pamja e Shqipërisë dhe e Kosovës sot, babë, pamje që na tronditin të gjithëve që besuam në idealizëm se jeta funksionon vetëm me ëndrra dhe se barku ushqehet vetëm me ideale...

Keq, a?!



Malësor Prënkocaj

Këngëtari flinte mbi eshtrat e Isa Boletinit!

Ditë më parë në “Alsat” të Maqedonisë, i ftuar në studio nga gazetarja Flora Shabani, ishte këngëtari Malësori, nga Trieshi, komuna e Tuzit, i cili foli gjatë për jetën e tij personale, e sidomos për jetën në vendlindje. Por, edhe për shumëçka tjetër...

Këngëtari i njohur shqiptar, Malësor Prënkocaj, i njohur në publik me emrin Malësori, e që me hitin e tij “Kthehuni” u bë shumë i famshëm, është i lindur në Triesh të Tuzit. Ai ende i ruan me krenari dhe me ndjenjë të pastër kujtimet nga fëmijëria, por edhe më pas: reliefi i fshatit dhe rajonit përreth, traditat që e karakterizojnë rajonin e Malësisë së Madhe, shkollimin fillor dhe atë të mesëm në Podgoricë dhe studimet në Prishtinë në Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, e që nga ajo kohë jeton në Prishtinë. Me ndjenjë krenarie se ishte malësor tha se në fshatin e tij të lindjes gjithçka është ndryshe: Çdokënd e njih në fshat dhe çdokush të njih; çdokënd e përshëndet dhe të përshëndet, të pyet se jeni, si janë familja, si u shkojnë punët...

Sipas tij kjo është traditë e vjetër shqiptare që është ruajtur ende në Malësinë e Madhe dhe e karakterizon nga zonat e tjera shqiptare. Në intervistat që i kam dëgjuar prej Malësorit, e sidomos në këtë të fundit në “Alsat” të Maqedonisë, primare në jetën e familjes së tij është çështja kombëtare, e që, siç tha ai, festat kombëtare i kanë festuar dhe i festojnë me një ndjenjë të veçantë. Sidoqoftë, para një kohe, në një emision tjetër televiziv, pat treguar se gjatë kohës kur si fëmijë erdhi në Podgoricë me familje, shtëpia e tij ndodhej në periferi të qytetit, e që në afërsi ndodhej një varrezë me disa varre të vjetra që i quanin “Varret e turqve”, e që askush nuk përkujdesej për to, madje mbi varre kullosnin bagëtitë!

Tregoi se kur luanin me top, në vend të pushimit, bashkë me shokë herë-herë shtriheshin nën hijen e drunjve në tokën ku ndodheshin varret dhe nga lodhja i ziente gjumi. Tutje tregon se nga ato varre, me iniciativë të Bashkësisë Islame të Podgoricës, me në krye imamin, janë nxjerrë eshtrat e njerëzve të varrosur dhe janë transferuar në vend tjetër. Më vonë mëson se eshtrat e nxjerrë kishin qenë të heroit tonë kombëtar Isa Boletinit dhe të djemve e luftëtarëve të tij. Për fund, mund të them se Malësori, në intervistat që i kam përcjell, shihet qartë se është i ngritur në aspektin intelektual dhe mund të merret shembull për të mirë nga këngëtarët dhe të tjerët.

Isa Ilazi

COURTYARD[®]
BY MARRIOTT

MIRË SE
VINI N'SHPI!



Mirë se vini *n'shpi*



Kot kryen fakultet nëse nuk ke dajë a teze në pushtet!

Shoh një reklamë në një televizion tonin. Nuk po ia përmendi emrin, meqë mund të merret si paragjykim për kundër reklamë. Ndër të tjerash, apelohej që studentët të konkurrojnë sa më parë se numri i studentëve që do të pranohen është i kufizuar. Them me vete: Gënjeshtër se jo mahi! Pse e them këtë? Sepse, në të njëjtin fakultet e kam pasur djalin dhe vajzën dhe i kanë kryer me kohë studimet, por që nga ajo ditë punojnë jashtë profesionit që janë shkolluar... Derisa e dëgjoja në televizion reklamën, mua më paskësh shkuar koka andej-

këndej, në shenjë habie. Dhe, sjelljen time e paskëshin vërejtur djali e vajza ime. "Çka po e sjellë kokën babi?", më pyetën të dy, njëzëri. Nuk fola gjë, por heshta. Dua t'u them se të dy e keni kryer fakultetin dhe ngjashëm do ta kryejnë edhe studentët e rinj që do të regjistrohen, por mu duk se do ishte ofendim për ta. Megjithatë, edhe studentët e rinj do e kryejnë njëjtë fakultetin si fëmijët e mi, por do të sillen vërdallë poshtë e lartë nëse nuk kanë dikë që i përkrah në qeveri, në

kreun komunal, a në ndonjë parti që është në pushtet.

Me këtë rast më shkon në mendje se të varfrit presin punë që të fitojnë sa të ngopen bukë, kurse të pasurit zgjidhen postet ambasadorë e konsullarë edhe pa ditur se ç'është diplomacia...

Ç'shollim kanë bërë ata që janë zgjedhur ambasadorë?

Asnjë shkollë adekuate pos që janë të afërm të politikanëve apo në vijë të politikës ditore...

Eh, të mjerët ne në ç'gjendje jemi?!

Selim Rama



Dasmë në Kosovë në vitet '70

Pse dasmat dikur e kishin madhështinë e vet e sot jo?

Dikur, por jo edhe fort moti, te ne dasmat e kishin madhështinë e vet më shumë sesa që e kanë sot. Pse dikur e kishin e sot jo?

Përgatitjet për dasmë fillonin, së paku, një javë përpara ditës së marrjes së nuses. Tuboheshin të afërmit e dhëndrit, kryesisht gratë dhe fillonin përgatitjet për dasmë. I dërgoheshin nuses disa ditë përpara teshat e nusërisë. Ndërkaq, vajzës që do të bëhej nuse të enjten i vëhej kana (kanagjeqi). Këngët e dasmave jehonin te të dy familjet, këngë të cilat i këndonin kryesisht vajzat e reja, shoqëruar me def, deri në ditën kur nusja dilte nga shtëpia e vajzërisë. Ndërkaq, në shtëpinë e dhëndrit dasma vazhdonte edhe ditën tjetër pas marrjes së nuses me të ashtuquajturin "thyerja e

kulaçit", kulaç të cilin e thyente dhëndri në prani të disa anëtarëve të familjes dhe miqve të shtëpisë.

A BËHEN EDHE TASH DASMA TË TILLA?

Në kohën e tashme dasmat zgjasin pak, për të mos thënë vetëm një ditë, ditën që merret nusja.

Gjatë ditës merret nusja e në mbrëmje krushqit e të dy familjeve tubohen në restorant dhe kah mesnata secili në shtëpinë e vet, udhës së vet... Mirëpo, ende ka familje që mundohen ta

ruajnë traditën e vjetër të dasmës shqiptare, të shtyrë nga nostalgjia e dasmave të dikurshme shqiptare, e që dalloheshin nga dasmat e popujve të tjerë në Ballkan. Në një të tillë, fatmirësisht, pata rastin të jem i pranishëm verës së kaluar në familjen Shala në Ngucat të Malishevës, e që oda e madhe ishte e stërm bushur nga mysafirët të cilët i mallëngjeu me këngët e shumta folklorike rapsodi Rifat Draga me grupin e tij. Prandaj, rikthimi në të kaluarën, e që tregon se kush ishim dikur si popull, nuk i bën keq as të sotmes...

AFTER
LIPOFILLING

BEFORE
NATURAL

 **anaderm**
— AESTHETIC SURGERY —

A close-up portrait of Blair Isufi, a woman with long, wavy brown hair, looking directly at the camera with a slight smile. She is wearing large, round, sparkling earrings and a black top. The background is a plain, light grey.

BOOM

Blair Isufi,
missi i Kosovës në "Miss World":
Një miss duhet të ketë zë!

Nga modelingu te misioni humanitar, nga marketingu te skena e konkurseve të bukurisë, Blair Isufi e sheh kurorën jo vetëm si simbol bukurie, por, mbi të gjitha, si përgjegjësi dhe mundësi për të përcjellë një mesazh. E lindur në Fier, me rrënjë nga Ferizaj dhe e rritur në Shtetet e Bashkuara, ajo ka ndërtuar një profil që ndërthur modën, biznesin, kulturën dhe angazhimin social.

E diplomuar në Marketing (aktualisht Marketing Menaxher), Blair prej vitesh është aktive edhe në modeling.

Ajo është edhe themeluese e Fondacionit “Mendora”, që promovon ndërgjegjësimin për shëndetin mendor përmes artit, si formë shërimi dhe vetëshprehje. Së fundi, rrugëtimi i saj në konkurset e bukurisë ka marrë një dimension të ri: Blair Isufi do e përfaqësojë Kosovën në “Miss World”, që organizohet në Vietnam në muajin shtator, duke e kthyer këtë eksperiencë në një mundësi për t'i prezantuar në një skenë ndërkombëtare jo vetëm bukurinë, por edhe kulturën, identitetin dhe vlerat e Kosovës.

Në këtë intervistë për Revistën tonë, Blair flet për rrënjët, modelingun, përgjegjësinë e të qenit miss, pasiguritë, jetën përtej kamerave dhe dëshirën për t'u kujtuar jo thjesht për bukurinë, por për gjurmën që lë...



Blair Isufi, missi i Kosovës në “Miss World”: Një miss duhet të ketë zë!

Për ata që nuk të njohin, kush është Blair Isufi dhe pse quhesh Blair?

- Jam e lindur në Fier, me rrënjë nga Ferizaj dhe e rritur në Shtetet e Bashkuara.

Jam e diplomuar në Marketing, punoj si Marketing Menaxher dhe prej vitesh merrem me modeling.

Besoj te puna, disiplina dhe autenticiteti.

Përtej profesionit besoj shumë te kontributi ndaj komunitetit.

Dhe, për këtë arsye themelova Fondacionin “Mendora”, që promovon ndërgjegjësimin për shëndetin mendor përmes artit.

Në kohën e lirë më pëlqen natyra, udhëtimet dhe koha me familje e miq. Emrin Blair ma vunë miqtë kur isha e vogël dhe që me kalimin e kohës më mbeti.

Sot shumica më njohin si Blair, ndërsa emri Blerta lidhet me rrënjët dhe identitetin tim.

Je fituese e një titulli bukurie. Çfarë ndryshoi në jetën tënde pas këtij titulli?

- Titulli më dha një platformë më të madhe për të folur për kauzat që më përfaqësojnë.

Nuk e shoh vetëm si një kurorë, por si përgjegjësi për të përfaqësuar Shqipërinë me dinjitet dhe për të promovuar kulturën, turizmin dhe projektet e mia humanitare.

Tani ky rrugëtim merr një tjetër dimension, meqë do e përfaqësoj Kosovën në “Miss World” në Vietnam, në muajin shtator.

Është një përgjegjësi e madhe dhe një mundësi e jashtëzakonshme për ta prezantuar Kosovën me krenari në një skenë ndërkombëtare.

Si filloi pjesëmarrja jote në konkurse bukurie?

- Modelingun e kam nisur në moshë të re dhe gjithmonë më ka pëlqyer ta sfidoj veten.


Me kalimin e viteve kuptova se një konkurs bukurie nuk lidhet vetëm me pamjen, por edhe me ndikimin që mund të kesh.

Dhe, kjo më shtyu ta provoja këtë rrugëtim.

Çfarë do të thotë për ty të jesh miss sot, përtej pamjes fizike?

- Një miss duhet të ketë zë, vizion dhe empati.

Bukuria mund të të hapë një derë, por



karakteri, puna dhe mënyra si i trajton njerëzit janë ato që të mbajnë aty. Për mua është e rëndësishme ta përdor platformën time për të frymëzuar dhe për të sjellë ndryshime pozitive.

Sa punë fshihet pas një paraqitjeje që duket “perfekte”?

- Shumë më tepër nga sa duket: Ka përgatitje, kujdes për shëndetin, palestër, ushqim të balancuar, prova, udhëtime dhe shumë disiplinë.

Pas çdo fotografie apo daljeje publike ka një ekip dhe shumë punë që publiku nuk i sheh.

Cili është sekreti yt i kujdesit për lëkurën dhe bukurinë?

- Për mua sekreti nuk është një produkt, por kujdesi për veten. Mundohem t'i jap përparësi gjumit, edhe pse udhëtimet dhe angazhimet nuk ma mundësojnë gjithmonë një gjë të tillë. Gjithashtu, jam shumë e kujdesshme me SPF dhe pothuajse nuk dal kurrë pa të.

A ka pasur ndonjë moment kur ke qenë e pasigurt me pamjen tënde?

- Sigurisht. Kur isha më e re dhe sapo kisha nisur modelin, ishte e lehtë ta krahasoja veten me të tjerat. Në këtë industri je gjithmonë mes njerëzve të bukur dhe të talentuar, ndaj është e vështirë të mos biesh në atë kurth. Me kalimin e viteve mësova ta dua veten dhe ta vlerësoj individualitetin tim. Sot nuk krahasohem më me të tjerat; përqipem të jem versioni më i mirë i vetes...

Mendon se bukuria është dhuratë apo përgjegjësi?

- Të dyja: Është dhuratë, por edhe përgjegjësi, sepse rëndësi ka mënyra si e përdor platformën që të jep ajo bukuria. Në fund, njerëzit do i kujtojnë veprat e tua, jo vetëm fytyrën.

Sa e vështirë është të përballesh me komentet dhe standardet që vendosen për një miss?

- Gjithmonë do të ketë komente dhe pritshmëri. Kam mësuar t'i dëgjoj kritikën konstruktive dhe të mos i lejoj opinionet negative të përcaktojnë vetëbesimin tim. Kur e di kush je dhe çfarë përfaqëson, është më e lehtë të mos lejosh që zhurma e jashtme të të largojë nga rruga jote.

Nëse do ndryshoje ndonjë gjë te vetja, cila do të ishte?

- Do të doja të mos i lija ndonjëherë gjërat për momentin e fundit.

Më pëlqen të kem shumë projekte njëkohësisht dhe ndonjëherë i shtyj disa më shumë seç duhet. Është diçka për të cilën po punoj çdo ditë. Përtej kësaj, nuk do të ndryshoja asgjë, sepse edhe sfidat më kanë ndihmuar të bëhem personi që jam sot.

A të ndodhë që njerëzit tremben të të afrohen, sepse të shohin si “shumë të bukur”?

- Më kanë thënë shpesh se u jam dukur e paarritshme, por sapo më njohin kuptojnë se jam shumë e thjeshtë dhe e komunikueshme.

Më pëlqen që njerëzit të më njohin përtej përshtypjes së parë...

Cila është situata më qesharake që të ka ndodhur gjatë një sfilate a fotosesionit?

- Gjatë një fotosesionit në Vërmosh, pjesë e setit ishte edhe një dhi që e mbaja me litar. Në një moment e lëshova pa dashje dhe ajo filloi të vraponte. Ekipi vrapoi pas saj nëpër fushë. Posa e zunë shpërthym me qeshje...

Nëse do të duhej të zgjidhje: Një javë pa telefon apo një javë pa pasqyrë?

- Pa pasqyrë. Telefoni është pjesë e punës sime si Marketing Menaxher dhe në modelin. Me telefon komunikoj me ekipet dhe i menaxhoj projektet. E, pa pasqyrë mund të jetoj pa problem...

Cili kaloni më shumë kohë para pasqyrës: ti a partneri yt?

- Aktualisht nuk kam partner, kështu që rekordin e mbaj unë.

Në fund, si do të doje që njerëzit të të kujtonin: si vajzë shumë të bukur apo si femër që ka lënë gjurmë?

- Pa asnjë dyshim: Si femër që ka lënë gjurmë.

Bukuria është e përkohshme, ndërsa ndikimi që lë të njerëzit dhe puna që bën për komunitetin mund të zgjasin shumë më tepër.

Nëse një ditë njerëzit më kujtojnë për projektet e mia, kauzat që kam mbështetur dhe mënyrën si i kam frymëzuar të tjerët, atëherë do e konsideroj suksesin tim më të madh.

Faleminderit për bisedë!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri



AH BRE, SHUMË E KAM DASHUR ZARIFEN!

Kur e kam takuar për herë të parë Zarifen në Shkollën Normale në Ferizaj, nuk kam qenë në gjendje ta kontrolloja veten. Ndryshova gjithçka te vetja vetëm e vetëm për të arritur qëllimin përfundimtar: ta për-vetësoja Zarifen.

Kam pasur një parim të thjeshtë: sado e bukur që të jetë një femër, nuk e lija kurrë pa ia thënë një fjalë, qoftë edhe nëse ajo nuk më dëgjonte...

Por, dashuria me Zarifen ka qenë krejt ndryshe, sepse ishte e vetmja femër në jetën time, në të cilën rashë në dashuri si i marrë. Asnjëherë tjetër nuk më kishte ndodhur të më turbulloheshin mendtë para një femre siç ishte Zarifja...

Me Zarifen jemi njohur në Shkollën Normale në Ferizaj dhe filluam t'i afroheshim njëri-tjetrit.

Ishte shtator, nxehtë, kështu që veshja e saj verore menjëherë ma dridhi trupin. Kam pasur një shprehje të keqe: kur shihja një

femër të bukur, më rrëqethej trupi dhe nuk dija as vetë si arrija aty për aty të gjeja një mënyrë për ta ngacmuar. E kthyer me shpinë prej meje, këmbëgjatë dhe zeshkane, më bëri përshtypje qëndrimi i saj i drejtë...

SI U DASHUROVA MARRËZISHT NË ZARIFEN?

Që në njohjen e parë e pash se si më "hëngri" me sy që nga këmbët deri te flokët dhe prapë rrinte e buzëqeshur.

Vetë mënyra se si ishte kthyer prej meje dhe më shikonte me bisht të syrit, tregonte se asaj po i pëlqeja nga çasti në çast.

Edhe pse ishte shumë e bukur për dallim nga unë, ajo nuk më refuzonte, nuk më injoronte, nuk ikte prej meje... Përkundrazi, dëshironte të komunikonte me mua në korridoret e shkollës gjatë pushimit ndërmjet orëve... Ndoshta më tepër më linte përshtypje stili se si vishej, e për këtë arsye mua m'i mori mendtë.

Ndonjëherë mendoja se ndoshta ajo bën pjesë në grupin e atyre femrave të bukura, të cilat vuajnë më së shumti për mashkull, sepse djemtë kur i shikojnë se janë të bukura, nuk kanë guxim t'u afrohen, sepse kujtojnë se s'kanë shans t'i zënë.

Një ditë i thashë se deri më tash kurrë nuk kam pasur dashnore. Këtë ia thashë që të shihja se si do reagoonte...

Në çast ajo qeshi dhe ma ktheu:

"Edhe ti si unë qenke, a?!"

Dhe, tërë atë pasdite dhe as natën nuk më është hequr nga mendja pamja e saj mad-

hështore dhe ashtu në largësi e dashuroja dhe fillova të ndieja diçka që s'kisha ndier asnjëherë në jetën time për asnjë femër tjetër: vuajtjen.

Të gjitha femrat që kisha njohur para Zarifes nuk më kanë ngazëllyer aq shumë si ajo dhe nuk ma kishin rrëmbyer zemrën, sepse gjithnjë femrat i kam dashuruar me kokë, por jo edhe me zemër.

Me Zarifen ndodhte diçka krejt tjetër që nuk e kisha provuar më parë, aq më tepër kur tërë atë ditë dhe tërë atë natë nuk e di sa herë isha shikuar në pasqyrë dhe nuk më besohej se ajo femër kishte folur me mua.

Në ndejat tona asnjëherë nuk e kam pyetur se a kishte pasur dikë tjetër para meje, sepse, thjesht, nuk më dukej normale ta pyesja...

Shtatë muaj e gjysmë kemi qenë bashkë dhe kushedi sa do të ishim sikur të mos ndodhte e papritura: Një shoqe e saj i kishte thënë se më njihte mirë dhe se isha një nga aventurierët e shkollës sonë...

Dhe, nga ai moment, sa herë i afrohesha në korridoret e shkollës apo edhe në oborrin e shkollës i ikte takimit ballë për ballë...

E, TASH?

Tani, në këtë moshë që kam, shpesh i them vetes: Asgjë në këtë jetë nuk po t'u kujtuaka përveç femrave që i ke pasur. Këtë mendim e kam nxjerrë nga fakti kur i kujtoj vajzat që kanë hyrë e dalë nga "dyert" e jetës sime...

Sidoqoftë, asnjë femër nuk e kam marrë në qafë, nuk ia kam marrë virgjërinë. Të gjitha femrat që kanë ardhur te unë kanë pasur para meje një, dy apo më tepër dashnorë, për të cilët mua kurrë nuk më ka interesuar.

Rama, Ferizaj


DAWN PATROL
RECORDS

antidot

TAKES OVER BATOS

21 AUGUST / 21:00



ENTER | BATOS FRIDAYS | MARINA BAY, VLORE



Në hall me vetveten...



Jam bërë për hajmali të madhe!

Gjithmonë arrije para meje në vendtakim. Atje, nën hijen e blirit, rrije ulur në një karrige me njërën këmbë hedhur mbi tjetrën dhe freskoheshe nga era e lehtë që frynte asaj vere. Prisje njeriun që e adhuroje, e i cili kishte lënë gjurmë në zemrën tënde. E, ai njeri isha unë...

"Pse je i mërzitur? Je njeri që reflekton kulturë, të cilën e gjen vetëm te njerëzit e rrallë si ti...", më the posa u ula pranë teje.

"Jo, jo, nuk jam i mërzitur, përkundrazi ndjehem shumë i lumtur pranë teje. Po e ndjej aromën tënde, e cila më cytë që të përkushtohem me tërë qenien time. Ti je si ujëvarë që derdhet nga lartësia e malit, pikat e së cilës freskojnë zemrën time". Këto fjalë dashurie ia thashë derisa e vështroja të dashurën time, që dukej një zonjë e bukur dhe e pushtetshme. Te ajo për të satën herë vëreja tipare të rralla bukurie...

Atë verë ajo dukej si një fidan i shëndetshëm që kishte marrë rritjen kah qielli. Këmbët e bardha e të zbuluara nën fustanin e shkurtër, i jepnin pamje madhështore. I kishte shumë të veçanta: të drejta, të lëmuara, këmbë balerine. Si të tilla, ato zgjonin në mua ndjenjën me të cilat trazoheshin emocionet e mia, trazohej shpirti im fisnik, shpirt që tashmë ishte mishëruar me shpirtin e saj melankolik. Fustanin nuk e kishte shumë të hapur në grykë, por qafa e saj dukej e bukur si qafë gjirafe. Ishte e këputur në bel, gjë e cila e bënte shtathedhur dhe të lezetshme.

I kishte hije edhe vendi ku rrinte, të cilit dukej se po ia jepte gjithë bukurinë e saj. Sytë e saj të bukur kishin formën e një qershie të ëmbël. Nga ata sy shkrepnin shkëndija të zjarra, të cilat shprehnin zjarin e zemrës që po e digjte... Por, e keqja e gjithë atij përjetimi është se ka disa vjet që më nuk jemi bashkë, kurse ajo ka krijuar familje të re, madje është bërë edhe nënë e dy fëmijëve. E, edhe më e keqja është se që nga ajo kohë nuk më largohet dot nga mendja, meqë m'është ngulitur në shpirt si gozhda në dru kur ndryshket nga vjetërsia...

P. K.

Femrat kanë kujtesë më të fortë se meshkujt!

Mesatarisht femrat njohin fytyrat e shtatë personave në një situatë ku burrat kanë njohur vetëm pesë ose gjashtë fytyra.

Studiuesit në Kanada i kanë fokusuar ato situata kur krijohet një ndjesi "unë e njoh atë, por nuk po më kujtohet emri!".

Sipas studimeve, ndjesi të tilla ndodhin më shpesh te meshkujt sesa te femrat.

FEMRAT MË TË PRIRA SE MESHKUJT

Studimi i ri, i kryer në Universitetin "McMaster" në Ontario, Kanada, zbuloi një ndryshim të vogël, por të rëndësishëm në aftësinë e femrave për t'i kujtuar të njohurit e tyre. Mesatarisht femrat njohin shtatë fytyra të tilla, ndërsa meshkujt mesatarisht njohin vetëm pesë.

Ndërkohë që nuk duket si një ndryshim i madh, dallimi i vogël në njohjen e fytyrës do të thotë se meshkujt gjenden në situata më të vështira përballë shoqërisë sesa gratë.

FEMRAT KANË KUJTESË SUPERIORE

Një tjetër teori është se femrat përpunojnë informacionet vizuale në një mënyrë të ndryshme. Ideja shpjegon se, në përgjithësi, femrat priren të kenë kujtesë superiore episodike, aftësinë për të kujtuar skena të veçanta nga e kaluara.



DITË TË VËSHTIRA KANË ARDHUR...

Ku t'ia gjej djalit një nuse pa behane?

Nastradini donte ta merrte grua një femër paksa të verbër, që ajo t'i shihte vetëm përgjysmë gjërat, si kusht që ta ruante shtëpinë; t'ishte pak e shurdhër, që të mos i dëgjonte gjysmën e fjalëve në shtëpi, si dhe të çalonte nga pak, e që kur ai ta ndiqte ta zinte më lehtë.

Mirëpo, sot nuk e do askush një grua të tillë, sepse secili do që grua e tij të jetë pa asnjë behane, madje edhe reja e tyre...

Pse?



E nisa mbrapsht këtë shkrim, sepse unë nuk po mund t'i përcjellë proceset e tranzicionit, pjesë e të cilit është bërë çdo familje....

Shoh fqinjin tim si del çdo mëngjes nga shtëpia dhe niset në drejtim të zabe-lit, më pas kah kodra e Surgjakut, ku gurëthyesit ia kanë prishur bukurinë kodrës sime të bukur, duke shkatërruar ekologjinë.

I them gruas se ku po shkon ky farë fqinji çdo mëngjes...

A thua, duhet të jetë keq me mushkëri e del në ajër të pastër...

A thua, i nevojitet ecja...

Por, as këtu më ajër të pastër s'ka.

E, as ecja nuk i duhet, sepse është bërë si një lis i thatë...

"O burrë, a nuk e di, a?", më tha gruaja.

"S'di gjë, tërë ditën jam në punë...", ia ktheva.

"Nuk ka ku të rrijë në shtëpi! E kanë marrë nëpërkëmbë. Askush nuk e do, askush nuk e çmon. I ka humbur udha në oborr. Del nga shtëpia dhe ia ther kah të mundet..."

"I zoti i shtëpisë ka mbetur pa respekt, a?", pyes i habitur.

"Po, çfarë i zoti i shtëpisë ai, bre?! Mos u bë francez!", ma ktheu.

"Unë francez, a?! Mirë do të ishte vetëm të mos jem kështu si jam, sepse fatin e keq e kisha pas moj grua. Po shoh keq e po më dhemb shpirti, e nuk po kam fuqi gjërat t'i ndryshojë. Po lëndohem nga pamjet e shëmtuara që po ndodhin çdo ditë..."

Madje, nuk e paskam ditur se e paskësh gjetur zezëdita fqinjin tonë, që ishte një zotëri i anës sonë. Është ditur kur zgjohen në shtëpinë e tij anëtarët e shtëpisë, është ditur kur fikën dritat natën, është ditur kur lidhet qeni i shtëpisë e kur këndon gjeli. Është ditur kur tymon oxhaku e kur qitet pushkë...

E tash, nuk po u ditka a këndon pula a gjeli në shtëpinë e tyre. Pse kështu, moj grua?!", e pyes.

"Kur e përzien pjellën e keqe ajo shtohet pa kontroll e ta prishë shtëpinë, ashtu si e prishë pirravina arën! Pirravina kudo që prekë në tokë qet rrënjë dhe e mbushë arën bari, e nuk ka më aty bereqet! Edhe familja e fqinjit tonë është e tillë, është mbushur shtëpia me lozë të këqija e burri i shtëpisë nuk ka vend më aty".

"Haj medet çka e paska gjetur fqinjin tonë!", i them gruas, më shumë për ta përmbyllur këtë muhabet.

LEJ HALLKUN, SHIKOJE SHTËPINË TËNDE!

Por, gruaja nuk ndalet me kaq... Më thotë të mos e marrim nëpër gojë askënd, sepse edhe në shtëpinë tonë kanë ndryshuar gjërat si te fqinji ynë, si rasti me Nastradini: Kish dal Nastradini në krye të

katundit dhe po e sillte një shkop.

Kalon atypari një kalimtar dhe i thotë: "Puna e mbarë, hoxhë efendi! Çka po bën me atë shkop?"

"Kam dëgjuar se po vjen një sëmundje e kam dal ta tremb që të mos hyjë në fshat!", ia kthen Nastradini.

"Shumë mirë, hoxhë efendi", i tha kalim-tari dhe vazhdoi tutje.

Gjatë natës sëmundja kishte depërtuar në fshat dhe Nastradini, kur e kuptoi se sëmundja kishte depërtuar, mori shkopin dhe doli në krye të mëhallës e nisi ta sillte rreth vetes.

Edhe me këtë rast, kalimtari i rastit, i thotë:

"Punë e mbarë, hoxhë efendi! Çka po bën me shkop?"

"Po e ruaj mëhallën që sëmundja të mos futet se na mbytë të gjithëve", ia kthen Nastradini.

Por, gjatë asaj nate sëmundja kishte depërtuar edhe në mëhallë. Nastradini e kishte marrë shkopin dhe kishte dal në oborrin e vet dhe po e sillte. Kur e pa gruaja, i tha:

"Je çmendur Nastradin! Çka po e sjellë atë shkop rreth trupit?!"

"Po e mbroj shtëpinë që të mos futët sëmundja e keqe në të!"

Por, të nesërmen prapë e shohin me shkop në dorë duke e sjellë rreth vetes.

"Ç'bën prapë, hoxhë efendi?!", i thotë gruaja.

"Po e ruaj veten se sëmundja hyri edhe në shtëpi!", ia kthen Nastradini.

"Demek, grua, edhe në shtëpinë tonë ka prekur ai virus, a?!", i them i befusuar.

PASDITE E PARË

"Mirëdita!", u them rejave.

E, ato, si nëpër dhëmbë, përgjigjen:

"Mirëdita!"

Secila telefonin në dorë...

Nëse duam të bëjmë muhabet përtojnë të flasin...

Gruaja më shikon në sy dhe ma pret:

"A je për çaj a për kafe?"

"Dua çaj", i them.

Ngrihet gruaja dhe niset drejt shporetit. E vë gjygymin mbi shporet dhe herë-herë më shikon mua.

Rejat nuk flasin. Çile gur gojën, thotë populli.

"Au, sa keq qenka bërë në shtëpinë time!", e mendoj në vete.

"Rejat e mia, a u ka rrahur kush, a?!", i pyes.

"Vallahi mua s'ka kush më rrahë se burri im është tri ditë larg me aeroplan!", thotë më e reja.

Hy pak në "botën" e shtëpisë sime dhe shoh se një atmosferë e zymtë shihet në fytyrën e gruas sime, e cila qenkësh bërë e huaja në shtëpinë e saj, ku ka jetuar, jeton dhe punon qe sa e sa dekada...

"E ti, grua?", i them sa për të vazhduar bisedën.

"Unë, kështu, çdo ditë, njeri..."

Rri vetëm...

Nuk më flet askush!

Kur dalin rejat në qytet fëmijët m'i lënë mua! E, kur kthehen as që më falënderohen, madje! "Fëmijët e djemve tu janë!", më thonë.

"Po, a?!", i them teksa më rrëqethet trupi.

"Burrë, mos më bë nervoz, se nuk je në ngjarje fare! Shihe situatën dhe bindesh edhe vetë!", ma ktheu ajo.

"Çudi, si nuk e paskam vërejtur një gjë të tillë, bre! Qenka prishur harmonia në shtëpi!", i them.

Pas pak, pasi e shoshita mirë situatën, i them gruas:

"Grua, e gjeta ilačin!"

"Fol, bre?!"

"Kur i gjetëm djalit të madh nuse, më the nuk më intereson kah është nusja veç a është e bukur!"

Edhe për djalin e dytë ishte po me ato fjalë...

Kurrë nuk të kam dëgjuar të thuash, o njeri, të pyesim çfarë loze ka, a mos është pirravinë që na e mbushë arën me bari. Por, vetëm kemi kërkuar nuse të bukura!", ia mbylla gojën.

PASDITE E DYTË

Shfletoj një libër nga sociologjia. Nuk gjej asgjë pos gjëra të përgjithësuara, rregulla...

Pas pak marrë librin me anekdota të Nastradin Hoxhës.

E shfletoj dhe hasi në një tregim intere-sant:

Nastradini para se t'i gjente nuse djalit, kishte dalë në shtatë fshatra dhe kishte kërkuar nuse për të birin, por kushtet për të qenë nuse e djalit të tij ishin:

Të jetë e verbër në njërin sy; të jetë gungaçe; të jetë e çalë në njërin këmbë; të ketë gjuhë të vogël; të mos ketë flokë të gjata...

Kur shkoi në fshatin e fundit të nahisë, gjeti një vajzë përafërsisht siç e kërkonte dhe e mori me vete.

Kur e solli në shtëpi erdhën mëhalla ta urojnë.

E, kur e panë nusen të verbër, e pyesin:

"A nuk pate sy Nastradin që e more këtë re të verbër, a? A e di çfarë djali të bukur ke?"

"Unë e gjeta një re të tillë për djalë, sepse ajo i sheh vetëm gjysmën e gjërave që ndodhin në shtëpi, kurse rejat tuaja shohin më shumë!"

E gjeta me një këmbë të çalë, sepse nëse nervozohet nuk mund të na zë të na rrahë!

Është pa flokë të gjata dhe nuk ka nevojë të shkojë çdo ditë te floktarja për t'i dredhë e zhdredhë!"

"E, pse e more gungaçe?", pyet njëri.

"Ku të gjesh re pa behane?!", ia kthen Nastradini.



Hormonet që ndikojnë në

*Peshë

*Oreks

*Metabolizëm



LEPTINA

Hormoni i ngopjes, sinjalizon trurin për të rregulluar kaloritë dhe yndyrën



GHRELIN

Hormoni i urisë, stimulon oreksin kur trupi ka nevojë



INSULINA

Rregullon sheqerin në gjak dhe ruan energjinë si yndyrë.



HORMONI I RITJES

Ndihmon në rritjen e muskujve dhe metabolizmin e yndyrës.

E pafat kisha qenë...

A ka mashkull për mua?

“Ndoshta mund ta merrni jonormale kur them se po vuaj shumë për mashkull, me të cilën do ta ndryshoja jetën time deri tash të tmerrshme!

Në vjeshtë i bëj 41 vjet dhe ende nuk e kam provuar kënaqësinë time të parë...”, thotë Naza nga Klina, në një kafene në qytet, teksa ishte në shoqëri me një shoqe timen të studi-meve.

Dëshiroj të njihem me një mashkull, i cili do t’më bënte të lumtur në shtrat, në jetë... Thjesht, nuk dua më të vuaj dhe t’i lakmoj shoqet e mia të cilat që moti janë martuar, i kanë edhe nga disa fëmijë dhe janë të lumtura.

Mjaft kam vuajtur dhe po vuaj pa dashuri. Dua edhe unë të modernizohem dhe të dashuroj: dua të mos jem më e virgjër dhe e ndrydhur në vetvete dhe të jetoj si e vdekur”, tha Naza, 41 vjeçe, nga Klina, e cila nuk di se çka është jeta qysh se e ka kryer shkollën e mesme dhe s’pati fatin të regjistrohej në fakultet shkaku i skamjes në familjen e saj.

BOLL JETOVA NË VETMI!

“Kam vendosur absolutisht: dua të bëj dashuri me mashkullin e parë që e takoj dhe më dashuron. Definitivisht nuk do t’i largoj më meshkujt, si dikur kur isha në shkollë të mesme, kur edhe i largoja pa një e pa dy.

Jo, dua të bëj dashuri dhe s’do t’i hakmerrem askujt edhe po qe se më lë.

Jam përcaktuar për një rrugë tjetër të jetës, edhe nëse më bie keq.

Fundja, pse të vazhdoj të jetoj në vetmi dhe e mbyllur në shtëpi?

Ç’më solli vetmia pos vuajtjeve?

Pse të rri në dritare duke i shikuar çiftet teksa shëtisin bashkë?

Pse t’i lakmoj ata teksa puthen me njëritjetrin?

Pse t’i xhelozoj moshataret e mia, të cilat janë martuar qëmoti dhe kanë krijuar familje?


Sidoqoftë, jam e vetëdijshme për një fakt: të gjitha vajzat që në rininë e tyre janë kënaqur, më lehtë edhe janë martuar, kurse ato si unë kanë mbetur fillikat vetëm dhe plaken në shtëpi me vuajtje në shpirt, siç po ndodh edhe me mua.

Andaj, do vë gishtin në kokë dhe do mendohem: Deri kur kështu?!

D. Haxhaj



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP




@dentfix ks


+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC